



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.733/2021

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët Afijete Sada Glllogjani kryesuese, Adnan Konushevci dhe Ferki Xhaferi anëtarë, duke vendosur përkritazi me apelin e kandidatës për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Lipjanit Mirishahe Tasholli nga Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje, me seli në Prishtinë, dega në Komunën e Lipjanit, paraqitur kundër vendimit me nr.2948-2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021 për Kuvendin Komunal, në seancën e panelit të mbajtur më datë 06.11.2021, mori këtë:

## V E N D I M

**Refuzohet** i pabazuar apeli Anr.733/2021 i datës 03.11.2021, i ushtruar nga kandidatja për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Lipjanit Mirishahe Tasholli, nga Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje, me numër 9 në komunën e Lipjanit, për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021 për Kuvendin Komunal, me të cilën ka kërkuar rinumërim të votave në Vendvotimin me nr.1330e/02D.

## A r s y e t i m

PZAP-i, me datë 03.11.2021, ka pranuar apelin Anr.733/2021 të parashtruar nga Mirishahe Tasholli, kandidate për Kuvend Komunal nga radhët e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, me të cilën pretendon se në vendvotimin 1330e/02D vërehet qartë se tek numri i saj 9 prej Lëvizjes është cekur numri i votuesve ndërsa tek vendvotimi me nr.1330e/01D pala ka konfirmuar se e ka votuar ndërsa aty i kanë dalë 0 (zero) vota. Si dëshmi ankesës i ka bashkangjitur fotokopjen e komunikimit elektronik si dhe formularin e rezultateve të kandidatit.

PZAP-i, pas shqyrtimit të apelit, vlerësimit të pretendimeve ankimore, dhe në kuptim të nenit 105 paragrafi 1, dhe nenit 117 paragrafët 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

### **Apeli është i pa bazuar**

Nga shkresat e lëndës, rezulton se apeli i parashtruar nga Mirishahe Tasholli, kandidate për Kuvend Komunal nga radhët e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje me të cilën kërkon rinumërim të votave në vendvotimin 1330e/01D është i pa bazuar.

Paneli, vlerëson se parashtruesja e apelit në mbështetje të pretendimeve të saj, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse lidhur me shkeljet e supozuara për mospërputhje të rezultateve, edhe pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, e në rastin konkret, Paneli pasi verifikoi listat e vendvotimeve të publikuara nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) konstatoi se vendvotimi i pretenduar si në apel me nr.1330e/01D me këtë numër nuk ekziston në asnjë qendër të votimeve të Kosovës, andaj edhe si të tillë e refuzoi si të pabazuar.

Andaj, Paneli vlerësoi se apeli i parashtruar nga Mirishahe Tasholli, kandidate për Kuvend Komunal nga radhët e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje nuk është bazuar në dëshmi të qarta dhe bindëse ashtu siç përcaktohet në nenin 117 par.3, të LZP-së, pasi që nga shkresat e lëndës nuk mund të vërtetohet se ka ndodhur ndonjë shkelje gjatë numërimit të votave për kandidatin.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë e në kuptim të neneve 115 paragrafi 1, 117 dhe 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**  
**Anr.733/2021 më datën 06.11.2021**

**Kryesuesja e Panelit**  
**Afijete Sada Gllgjani**

***Këshilla Juridike:** Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par.4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes në pyetje të këtij vendimi.*

